



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 5782/2 Prot.

Laç, më 26 / 12 / 2023

VENDIM

Nr. 44 datë 19 / 12 / 2023

**“MBINDARJEN E BURSAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT TË MESËM  
PROFESIONAL PËR VITIN MËSIMOR 2023 -- 2024”**

Bazuar në ligjin Nr.139/15, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 27. 07. 2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, në shkresën Nr.19749 Prot. datë 30.10.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2023-2024” sipas së cilës numri i bursave për Bashkinë Kurbin është 50 (pesëdhjetë), Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga nxënësit e interesuar, si dhe shqyrtimin dhe miratimin në parim nga Komisioni i Arsimit të Këshillit Bashkiak. Si dhe pas propozimit nga komisioni Arsimit, Kulture dhe sporteve, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI :**

Të miratohet 31 kërkesat për ndarjen e bursave të nxënësve të listuar sipas kriterëve përkatës në tabelën bashkëlidhur vendimit .

Ky vendim hyn në fuqi 10 dhjetë ditë pas shpalljes

Përzbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetaria e Bashkisë.

->Prefektit Të Qarkut Lezhë

->Drejtorinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve

->Arkivi

SEKRETARI I KESHILLIT

Arber LEKA



KRYETARE E KESHILLIT

Edlira LLESHI